# DËSHMI ARKIVI

**A-447553**

VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Bugaqku: S'e kemi pasur një situatë kur shkelet qëllimshëm afati i konstituimit të Kuvendit |
| ADRESA | `https://www.koha.net/arberi/bugaqku-se-kemi-pasur-nje-situate-kur-shkilet-qellimshem-afati-i-konstituimit-te-kuvendit` |
| BURIMI | koha.net |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 16 shtator 2026, 02:55:58 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 15 shtator 2026, 16:15:31 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `907af0b1c97c6cfdee8726ae223d68bb360e49fe083931ffcad1fd7e98671c4a` |
| TEKSTI | `ccecd414609442a95d2648d78d4a462dfff9e06501394ccbd54ef725a40925b2` |
| PAMJA | `937cccdc696c45dad69cf6d0cd6abdce98321e291d4d9de58e2bb84e55bb5965` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `43386923b8ff266443a9488818b203625b1cec9e26cc71b01533411c071a7f9a` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `e059d51b19570df3bab28500acd4aaa952456ce184f2a2e88bb7ab7ef9d7b2bd` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/43386923b8ff266443a9488818b203625b1cec9e26cc71b01533411c071a7f9a`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Mbështete KOHËN. Ruaje të vërtetën Kontribuo → Letër lexuesit

ARBËRI

# Bugaqku: S'e kemi pasur një situatë kur shkelet qëllimshëm afati i konstituimit të Kuvendit



15 shtator 2026 18:15

Shpërndaje në:

Klikoni këtu nëse dëshironi t'i lexoni lajmet e fundit dhe të përzgjedhura në kanalin tonë zyrtar në Viber

Hulumtuesi në Institutin Demokratik të Kosovës, Vullnet Bugaqku, ka thënë se ne ende nuk e kemi pasur një situatë kur është shkelur afati 30-ditor i thirrjes së seancës për konstituimin e Kuvendit, andaj ai ka kërkuar që pas dërgimit të saj në Gjykatën Kushtetuese nga Partia Demokratike e Kosovës, Kushtetuesja të sqarojë se çfarë pasoje juridike mund të prodhojë kjo shkelje.

Bugaqku në emisionin "60 Minuta" në KTV, është shprehur se në të ardhmen kjo do të mund të përdorej nga legjislaturat e tjera që ta përshtatin kohëzgjatjen e konstituimit me kalkulimet e tyre.

"Afati kushtetues për konstituimin e Kuvendit përfundoi më 7 gusht dhe i njëjti u shkel. Tash duhet të sqarohet çfarë pasoje juridike prodhon kjo shkelje, nëse mund të vazhdohet procesi pas skadimit të afatit, dhe nëse po, mbi cilat rregulla do duhej të ndodhte kjo. Lënia pezull e kësaj çështje u krijon hapësirë akterëve politik që edhe në legjislaturat e ardhshme ta përshtatin kohëzgjatjen e konstituimit me marrëveshjet dhe kalkulimet e tyre", ka thënë Bugaqku.

Tutje Bugaqku ka thënë se nuk përjashtohet mundësia që Gjykata Kushtetuese kësaj radhe të parashikojë ndonjë masë e cila do t'i vetëdijësonte të zgjedhurit e popullit për të mos shkelur afatet e konstituimit të Kuvendit, si organi përfaqësues i qytetarëve.

"Mund të diskutohen edhe modalitetet që Gjykata Kushtetuese t'i interpretojë në kuptimin e pasojave për shkak të cenimit të rendit kushtetues të Republikës së Kosovës. Nuk është vepër penale në kuptimin e përgjegjësisë penale, por është më tepër shkelje e rëndë e Kushtetutës nga ana e përfaqësuesve të popullit që e kanë marrë mandatin për ta konstituuar parlamentin dhe nuk e kanë dërguar deri në fund amanetin e popullit si organin përfaqësues të tyre, atëherë i bie që ata të jenë në kundërshtim me vullnetin politik që i ka zgjedhur. Prandaj mbase Gjykata edhe mund të kalkulojë dhe të parashikojë ndonjë masë që t'i vetëdijësojë këta deputetë që të mos bëjnë më shkelje të tilla", ka thënë Bugaqku.

PDK-ja një ditë më parë i është drejtuar Gjykatës Kushtetues duke kontestuar procedurën e konstituimit të legjislaturës së 11-

**Futboll.** Espi e shpëton Realin nga turpi

**Arbëri.** Kurti: Shqiptarët e Luginës kanë nevojë për bashkëpunim e përgjegjësi të përbashkët

**Arbëri.** Hehir: Turp i madh që një gjykatë e huaj që iu imponua Kosovës t'i shpallë fajtorë figurat e UÇK-së

**Futboll.** Zyrtare: Lionel Messi ftohet nga Argjentina

**Kulturë.** "Lufta nën akuzë..." demaskon rishkrimin e historisë së çlirimit

**Futboll.** Liverpooli eliminon Tottenhamin nga Kupa e Ligës

të e cila e votoi qeverinë Kurti 4, pasi zgjodhi kryetaren dhe 4 nënkryetarët e Kuvendit.

Edhe



**Arbëri** • 11 o. më parë

KDI: Kushtetuesja të sqarojë pasojat e shkeljes së afateve për konstituimin e Kuvendit

Nënkryetari i PDK-së nuk u zgjodh.

Sipas partisë më të madhe opozitare, Albin Kurti dhe partia e tij shkelën afatet kushtetuese me qëllim.

#VULLNET BUGAQKU #KONSTITUIMI I KUVENDIT #GJYKATA KUSHTETUESE #INSTITUTI DEMOKRATIK I KOSOVËS

## Artikuj të ngjashëm



**Arbëri** • 8 sht 2026

IKD: Kushtetuta mbrohet duke i dhënë fund shkeljes



**Arbëri** • 7 sht 2026

PDK-ja e LDK-ja konfirmojnë pjesëmarrjen në seancën "jashtë afatit kushtetues"



**Arbëri** • 1 sht 2026

Dilemat e juristëve për legjitimitetin e institucioneve që mund të dalin nga kjo legjislaturë



**Arbëri** • 7 gus 2026

Dështon konstituimi i Kuvendit brenda afatit 30 ditësh

KOHA

Kjo faqe kontrollohet dhe menaxhohet nga KOHA. Të gjitha materialet në të, përfshirë fotografitë, janë të mbrojtura me copyright të KOHA-s dhe për to KOHA mban të drejtat e rezervuara. Materialet në këtë faqe nuk mund të përdoren për qëllime komerciale. Ndalohet kopjimi, riprodhimi, publikimi i paautorizuar qoftë origjinal apo i modifikuar në çfarëdo mënyre, pa lejen paraprake të KOHA-s. Shfrytëzimi i materialeve nga ndonjë faqe interneti a medium tjetër pa lejen e Grupit KOHA, në emër të krejt njësive që e përbëjnë (Koha Ditore, KohaVision, Koha.net, Botimet KOHA, KOHA Print dhe ARTA), është shkelje e drejtave të autorit dhe të pronës intelektuale sipas dispozitave ligjore në fuqi. Të gjithë shkelësit e këtyre të drejtave do të ballafaqohen me ligjin.



Përkthimi i përmbajtjeve në gjuhët tjera bëhet në mënyrë automatike dhe mund të ketë gabime!

+383 (0) 38 249 105 / [email protected]

Aneksi i ish-Radio Prishtinës (kati i parë) Xhorxh Bush p.n., 10000 Prishtinë



Shkarkoje aplikacionin e KOHËS

Download on the App Store

GET IT ON Google Play

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.